



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:241197

Datë: 15.05.2024

Numri i dokumentit: 05690433

KPPP.nr. 1535/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbaremore të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale me seli në Prishtinë, rr. “Armend Daci”, nr. 1, kundër debitorit “Krasniqi” Sh.P.K., me numër të biznesit 70658836 dhe seli në Studecan, Komuna e Suharekës, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr. 386/21, i lejuar me datë 13.10.2021, nga Përmbareuesi Privat Saranda Kuçi me seli të zyrës në Prizren, me datë 15.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

NDËRPRITET procedura në çështjen përmbaremore të evidentuar me numër KPPP.nr. 1535/23, sipas Urdhrit Përmbaremore P.nr. 386/21 të lejuar nga Përmbareuesi Privat Saranda Kuçi me datë 13.10.2021, me kreditor Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe debitor “Krasniqi” Sh.P.K., me numër të biznesit 70658836, për shkak se debitori ka pushuar se ekzistuar.

A r s y e t i m

Përmbareuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumentit përmbaremore Aktvendimit për mos pagesë të rentës minerare nr. 5284, të datës 14.12.2020, ka lejuar Urdhrin Përmbaremore P.nr. 386/21, të datës 13.10.2021, me të cilin është urdhëruar debitori “Kastrioti” Sh.P.K., që kreditorit t’ia paguaj shumën e borxhit prej EUR 26,712.16 duke përfshi edhe interesin mujor prej 2 %, si dhe shpenzimet e procedurës përmbaremore.

Debitori, në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin mbi lejimin e përmbaremit me arsyetim se “Kastrioti” Sh.P.K., ka pushuar së ekzistuar dhe është çregjistruar nga regjistri i evidencave të shoqërisë tregtare për shkak të falimentimit. Andaj, gjykatës i ka propozuar që prapësimin ta aprovoj si të bazuar, ashtu që urdhri përmbaremore të anulohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se prapësimi i debitorit nuk është i bazuar dhe se debitori ka qenë i njoftuar me detyrimet ndaj kreditorit. Me tej, ka theksuar se debitori nuk e ka njoftuar kreditorin për procedurën e falimentimit në mënyrë që ti shmanget detyrimeve dhe një gj të tillë e ka bërë vetëm pasi që biznesi është shuar. Gjykatës i ka propozuar që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Themelore në Prizren, me Aktvendimin PP.nr. 53/21, të datës 27.05.2022 e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit ndërsa urdhrin përmbartimor P.nr. 386/21, të datës 13.10.2021 e ka anuluar.

Ndaj këtij aktvendimi kreditori ka paraqitur ankesë, ndërsa Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Dytë, me Aktvendimin K.Dh.Sh.II.nr. 408/23, të datës 05.07.2023 e ka aprovuar si të bazuar ankesën e kreditorit, Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren, Dega Suharekë, PP.nr. 539/21, të datës 27.05.2022 e ka anuluar, ndërsa lëndën e ka kthyer në rivendosje.

Kjo Gjykatë, në rivendosje, pas analizimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, erdhi në përfundim se procedura në këtë çështje përmbartimore duhet ndërprerë, andaj edhe u vendos si në dispozitiv e këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Nga shkresat e lëndës rezultojnë që si debitor në propozimin për përmbartim është evidentuar subjekti “Kastrioti” Sh.P.K., me numër të biznesit 70658836, e cila sipas shkresave të lëndës rezultojnë se është shuar si subjekt. Poashtu, lidhur me këtë fakt gjykata zyrtarisht është informuar nga ARBK-së, sipas shkresës së datës 25.04.2024, se debitori “Krasniqi” Sh.P.K., është regjistruar me datë 14.04.2010 dhe është shuar me datë 30.06.2021.

Në lidhje me këtë, sipas nenit 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore përcaktohet se “*Në procedurën përmbartimore përshtatshëmish zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën kontestimore, po qe se me këtë ligj ose me ndonjë ligj tjetër nuk parashihet diçka tjetër*”, ndërsa me nenin nenit 277, par.1, d) të LPK-së të me të cilën përcaktohet se “*Procesi gjyqësor ndërpritet: c) kur pala që është person juridik pushon së ekzistuari, respektivisht kur organi kompetent jep vendim të formës së prerë për ndalimin e punës tij*”.

Prandaj, gjykata në mbështetje të nenit 277, pika c) të LPK-së, vlerëson procedura në këtë çështje përmbartimor duhet të ndërpritet për shkak se debitori ka pushuar së ekzistuari, përkatësisht i njejti rezultojnë të jetë subjekt i shuar.

Gjykata, me rastin e vendosjes ka vlerësuar edhe sugjerimet e gjykatës së shkallës së dytë të dhëna në Aktvendimin K.Dh.Sh.II.nr. 408/23, të datës 05.07.2023, në raport me vlerësimin dhe aplikimin e dispozitave ligjore nga neni 133 i Ligjit Nr. 06/L-016 për shoqëritë tregtare, sipas së cilës dispozitë parashihet se *“1. Pas shfaqjes së rrethanave ose vendimit për shpërbërje vullnetare sipas nën-paragrafëve 1.1 ose 1.2 të paragrafit 1 të nenit 112 të këtij ligji, Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar vazhdon ekzistencën njëllor si më parë, por nuk mund të ushtrojë Veprimtari Ekonomike përveç atyre të nevojshme për shpërbërjen vullnetare dhe përmbylljen e veprimtarisë, të cilat përfshijnë, ndër të tjera pika 1.2. pagimin ose aranzhimin për plotësimin e kërkesave të kreditorëve; 1.3 shitjen pas përmbushjes së kërkesave të nenit 114 të këtij ligji, të aseteve jomonetare të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar; dhe 1.4. shpërndarjen e aseteve të mbetura pas shitjes dhe përmbushjes së kërkesave të kreditorëve”*, mirëpo kjo gjykata vlerëson se dispozita në fjalë i referohet periudhës kohore prej momentit të shfaqjes së rrethanave apo momentit të nxjerrjes së vendimit për shpërbërje vullnetare nga Kuvendi i Aksionarëve në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e deri në shuarjen e shoqërisë dhe regjistrimit të shuarjes në regjistrin përkatës të bizneseve. Ndërsa në rastin konkret, nga shkresat e lëndës rezulton se shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “Kastrioti” Sh.P.K., veç është shuar dhe se shuarja është pasqyruar edhe në regjistrin zyrtar të bizneseve, dhe rrjedhimisht është shuar subjektiviteti i tij ashtu që ndaj të njejtit nuk mund të zhvillohet procedurë përmbarimore.

Nga sa më sipër, konform nenit 17 të LPP-së, në lidhje me nenin 277, pika (d) dhe 280, paragrafi 1 e LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1535/23 , datë 15.05.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.